

NOTE INFORMUESE

Tiranë, më 11.10.2021

Mbi kërkesën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për procedim disiplinor me masën “Shkarkim nga detyra” ndaj magjistratit R.H.

Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka përfunduar hetimin disiplinor të nisur me iniciativë ndaj magjistratit R.H., ish-gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, për shkeljen disiplinore të parashikuar nga neni 140, pika 2, shkronja “b” e Kushtetutës dhe neni 104 i ligjit nr. 96/2016, i ndryshuar.

Nga provat e administruara rezulton se, me vendimin e datës 17.10.2019, Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë e ka deklaruar R.H. fajtor për veprën penale “Korrupsioni pasiv i gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të drejtësisë”, duke e dënuar fillimisht me 4 vjet e 6 muaj burgim. Në zbatim të nenit 406 të Kodit të Procedurës Penale, dënimi përfundimtar u caktua në 3 vjet burgim, së bashku me heqjen e së drejtës për të ushtruar funksione publike për 5 vjet. Vendimi është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit për Krime të Rënda Tiranë, e cila ka refuzuar ankimin e R.H., duke e bërë të qëndrueshëm konstatimin e përgjegjësisë penale të tij.

Kontekst: Procedimi penal ndaj magjistratit R.H. u regjistrua kryesisht mbi bazën e të dhënave të publikuara në emisionin investigativ “Stop” të TV Klan, më 08.01.2019. Në cilësinë e gjyqtarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, R.H. kishte në shqyrtim një çështje familjare lidhur me ushtrimin e përgjegjësisë prindërore dhe kujdestarinë e një fëmije të mitur. Gjatë gjykimit, gjyqtari, nëpërmjet psikologes E.M., kërkoi takim me palën e paditur dhe, sipas të dhënave të procedimit, i kërkoi favore seksuale, kërkesë të cilën ajo e refuzoi. Më pas, në kuadër të bashkëpunimit me emisionin “Stop”, denoncuesja regjistroi komunikimet me psikologun, e cila e orientoi atë t’i ofronte gjyqtarit 500 euro ryshfet në këmbim të marrjes së kujdestarisë së fëmijës. Në një takim të mëvonshëm, të zhvilluar në një ambient të veçuar, denoncuesja i dorëzoi R.H. shumën prej 500 euro, moment i cili u regjistrua filmikisht. Nga përmbajtja e bisedës rezultonte se kjo shumë lidhej me çështjen konkrete familjare që gjyqtari kishte në shqyrtim.

Nga hetimi disiplinor i kryer nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë, provohet se:

- Gjyqtari R.H. është gjetur fajtor për shkelje të rënda të natyrës korruptive, të lidhura drejtpërdrejt me ushtrimin e funksionit të tij gjyqësor.
- Veprimet e tij kanë diskredituar rëndë figurën e gjyqtarit dhe kanë cenuar besimin e publikut te gjyqësori, pasi ka kërkuar dhe pranuar ryshfet në këmbim të ndikimit në një çështje gjyqësore, si dhe ka kërkuar favore seksuale nga një palë ndërgjyqëse.
- Sjellja e tij ka cenuar funksionimin e rregullt të organeve të drejtësisë dhe integritetin e funksionit gjyqësor.
- Vepra është kryer me dashje direkte, me synim përfitimin financiar dhe marrjen e favoreve seksuale në këmbim të një vendimmarrjeje civile në favor të njërës palë.

Nw konkludim, Inspektori i Lartë i Drejtësisë i propozon Këshillit të Lartë Gjyqësor caktimin ndaj gjyqtarit R.H. të masës disiplinore “Shkarkim nga detyra” për shkeljet disiplinore të parashikuara nga neni 140, pika 2, shkronja “b” e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nga neni 104, pika 3, dhe neni 111, pika 1, shkronja “b” të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.